



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut  
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

Kryetari i Komunës

Nr. 01-113/04-0017212-2/26 dt. 03.04.2026  
Mitrovicë

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenet 14 dhe 77 të Statutit të Komunës Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020, nenet 14 dhe 27 të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe Kërkesën Nr. 01-113/04-0017212/26, dt. 01.04.2026 të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritim Evropian, Kryetari i Komunës sjell këtë:

#### V E N D I M

- 1. Aprovohet** Kërkesa Nr. 01-113/04-0017212/26, dt. 01.04.2026 e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritim Evropian, dhe i lejohe shpallja e Thirrjes Publike dhe shfrytëzimi i mjeteve financiare nga buxheti i Komunës së Mitrovicës së Jugut, në shumë prej 30,000.00 € (tridhjetë mijë euro), me qëllim të realizimit të projektit “Trajnim dhe Praktikë në Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara” sipas Planit të Punës së kësaj Drejtorie për vitin 2026.
- 2.** Mjetet e lejuara sipas pikës 1 të këtij Vendimi do të shfrytëzohen për realizimin e projektit të Drejtorisë në fjalë “Trajnim dhe Praktikë në Punë për Personat me Aftësi të Kufizuara”, dhe me qëllim të mbulimit të shpenzimeve për 20 (njëzetë) praktikantë për periudhën kohore prej 6 (gjashtë) muaj, ku pagesa mujore për 1 (një) praktikant do të jetë në shumë prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë euro).
- 3.** Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritim Evropian obligohet që të zhvillojë procedurat për përzgjedhjen e praktikantëve konform kriterëve dhe dispozitave të Rregullores Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve dhe kriterëve të Thirrjes Publike, si dhe dispozitave tjera ligjore nga fusha përkatëse.
- 4.** Thirrja Publike për realizimin e këtij projekti e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi, së bashku me kriteret do të publikohen në web faqen e Komunës, dhe e njëjta do të qëndrojë e hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga momenti i publikimit.
- 5.** Në përputhje me Rregulloren Komunale Nr. 08/2023 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve dhe Granteve, dhe me propozimin e Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritim Evropian, Kryetari i Komunës do të formojë Komisionin Vlerësues i cili do të bëjë vlerësimin e



aplikacioneve në përputhje me kriteret e përcaktuara me Thirrjen Publike dhe në këtë Rregullore.

6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian në bashkëpunim me Drejtorinë për Buxhet dhe Financa, ndërsa mjetet e parapara sipas këtij Vendimi paguhen nga kategoria ekonomike: Subvencione dhe Transfere të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian.
7. Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian është e obliguar të njoftojë përfituesit për kohën dhe datën e nënshkrimit të Kontratave.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetari i Komunës

Faton PEÇI

**Shtojcë:**

Kërkesa Nr. 01-113/04-0017212/26, dt. 01.04.2026, të Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian; Thirrja Publike e DEZHTIE-së.

**Ti dorëzohet:**

- 1x1 Kryetarit të Komunës
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 Zyrës për Informim
- 1x1 Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim, Turizëm dhe Integritet Evropian
- 1x1 Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- 1x1 Arkivit.

